

BASHKIA KOLONJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA .

2. Autoriteti: Bashkia Kolonjë

Adresa	Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax	+355 812 23173 ; 08122225 ; 2232
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com
Faqja e Internetit	http://www.kolonja.gov.al
3. Dhënie me qira, me konkurim publik, të tokës në pronësi të Bashkisë Kolonjë për Njësinë Administrative Qendër Erseke, fshati Rehovë me nr.pasurie 1840/3, Zona Kadastrale 3164,Rrethi Kolonjë,lloji pa frut,zallishtë me sipërfaqe 10.8 ha.
4. Qëllimi i dhënies me qira të pasurisë nr.1840/3, Zona Kadastrale 3164, Fshati Rehovë, Rrethi Kolonjë është dhënia në përdorim për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.
5. Konkurrimi do të zhvillohet më datë:05.01.2021, ora 11:00,në Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kolonjë.
6. Çmimi dysheme i qirasë, është 27,000 (njëzeteshtatë mijë) lekë/ha në një vit kalendarik.
7. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë 20 (njëzet) vjet.
8. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :

- a) Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit të parashikuar sipas planit të biznesit;
- b) Planin biznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë;
- identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen,
 - përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit
 - analiza e detajuar e afatit kohor, që do të duhet për të realizuar projektin investues dhe treguesit që do të realizohen brenda një periudhe jo më të gjatë se 1/4 e afatit të kontratës të cilët duhet të ruhen, deri në fund të afatit të kontratës si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij
 - niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.
- c) Çertifikatën e regjistrimit dhe Çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKB
- d) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore, ose deklaratë
- e) Vetëdeklarim se subjekti ofertues dhe administratori nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces/e gjyqësor/e që lidhet/n me aktivitetin.
- f) Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, ose deklaratë.
- g) Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfitozë në objekte pronë shtetërore të Bashkisë Kolonjë, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore të kësaj bashkie.
- h) Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2020 dhe për vitin e fundit 2021 (këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.
- i) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues
- j) Afatin e përdorimit të tokës objekt qiramarrje.
8. Ofertat paraqiten në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.
9. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:
- | | |
|---------------------------------------|---------|
| a) Niveli i Investimit | 35 pikë |
| b) Niveli i Punësimit | 35 pikë |
| c) Oferta e Detyrimit Mujor të Qirasë | 30 pikë |
10. Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë origjinale/fotokopje të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të tërheqin dokumentat e konkurimit brenda 5 (pesë) diteve nga data e shpalljes të këtij njoftimi, nga ora 10:00-14:00,

pranë Zyrës së Financës në Bashkinë Kolonjë kundrejt tarifës 1000 (njëmijë) lekë. Konkuruesit të cilët nuk kanë tërhequr dokumentat nuk mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese.

- 11.** Dokumentacioni do të dorëzohet në sekretarinë e Bashkisë Kolonjë deri më datë 05.01.2021, para orës 11:00.